

---

---

## MATERIALE SHKENCORE E KUMTESA

---

---

**BEQIR META**

### **NDIKIMI I LUFTËS SË VLORËS NË ZHVILLIMET E BRENDSHME NË SHQIPËRI\***

Lufta e Vlorës u zhvillua në një moment kyç dhe dramatik për fatet e ekzistencës së një Shqipërie të pavarur dhe të rikrijimit të shtetit shqiptar.

Fillimi dhe zhvillimi i kësaj lufte mund të portretizohen me shprehjen: në kohën, në vendin dhe në mënyrën e duhur.

E kombinuar edhe me një sërë rrethanash ndërkombëtare të favorshme, analiza e të cilave nuk është objekt i kësaj kumtese, ajo së bashku me Kongresin e Lushnjës ndryshoi rrjedhën e zhvillimeve ndërkombëtare të çështjes shqiptare, duke rikthyer sërish në rendin e ditës, rinjohjen e pavarësisë së Shqipërisë dhe të shtetit kombëtar shqiptar.

Por, zhvillimi i Luftës së Vlorës dhe përfundimi me sukses i saj, pati ndikim thelbësor në zhvillimet e brendshme politike në Shqipëri. Ky aspekt i saj është evidentuar në disa drejtime, por ende nuk është bërë një analizë e plotë dhe gjithëpërfshirëse, prandaj në këtë punim po përpiqemi të japim disa nga drejtimit ku Lufta e Vlorës ushtroi ndikimin e saj në zhvillimet e brendshme politike:

1. Në radhë të parë Lufta e Vlorës ndikoi në rritjen e entuziazmit dhe të frymës kombëtare në popullsinë shqiptare. Ndikimi i saj ka qenë i jashtëzakonshëm jo vetëm gjatë kohës që ajo u zhvillua, pra përgjatë verës së vitit 1920, por edhe pas përfundimit të saj, e madje shumë dekada më pas. Ajo ishte një vërtetim i qartë i devizës, se një komb kur është i vendosur të luftojë për të drejtën e tij sublime, pra për ekzistencën e tij, mund t'ia dalë mbanë.

---

\* Kumtesë e mbajtur në konferencën shkencore kombëtare me titull: "Lufta Kombëtare e Vlorës, luftë për mbrojtjen dhe rikonfirmimin e Pavarësisë", organizuar nga bashkia e Vlorës me rastin e 100-vjetorit të Luftës së Vlorës dhe Kongresit të Lushnjës, Vlorë, më 2 shtator 2020.

Ndikimi i kësaj lufte ishte në avancimin e nacionalizmit shqiptar, në rritjen e shkallës së pjekurisë së tij, e mbi të gjitha në rritjen e vetëbesimit të tij për të sendërtuar pavarësinë dhe shtetin kombëtar.

Duke qenë se u sigurua një fitore përballë njëres nga Fuqitë më të Mëdha evropiane të kohës, potenciali ushtarak, politik, diplomatik, ekonomik e njerëzor i së cilës ishte disa herë më i madh se ai i popullit shqiptar, ajo prodhoi një kthesë historike në shpirtin e kombit. Kjo ngjarje edhe pse në disa raste u hiperbolizua dhe u kthye në mit, pati rëndësi të madhe në këtë drejtim.

Ajo ishte një zjarr i pashuar, një ilaç shërues për shpirtin e kombit shqiptar të gjymtuar e të plagosur nga historia. Në këtë drejtim ajo pati një ndikim të jashtëzakonshëm në përballjet e sfidat e tij të ardhshme për sendërtimin e shtetit-komb, për rritjen e kohezionit të kombit shqiptar dhe për progresin e tij, prandaj mund të thuhet pa e tepruar se kjo ngjarje kruciale historike ka rëndësi edhe sot, si një frymëzim, si një ideal për ndërtimin e një shteti demokratik e progresiv, veçanërisht për tejkalimin e krizës shpirtërore, morale dhe identitare që ka krijuar tranzicioni i gjatë, i dhimbshëm dhe me zigzage sfiluese nga shteti totalitar komunist, drejt modelit të një shteti dhe shoqërie më demokratike dhe funksionale.

2. Lufta e Vlorës ishte në një farë mase produkt i kohezionit politik kombëtar që krijoi Kongresi i Lushnjës, por nga ana tjetër zhvillimi dhe përfundimi i suksesshëm i saj ndikoi për ta përforcuar më tej këtë kohezion, i cili gjithsesi duhet konceptuar në terma relativë dhe të përkohshëm.

Establishmenti politik i krijuar në Kongresin e Lushnjës përmes kësaj fitoreje sa ushtarake po aq edhe politike, e rriti dukshëm prestigjin dhe forcën e tij politike. Këto avantazhe ai i shfrytëzoi për rritjen e kapaciteteve qeverisëse, për rritjen e autoritetit të shtetit në popull, gjë që ishte një arritje historike, po të kihet parasysh se ky nivel, ndonëse ende modest, ishte më i larti po të krahasohet me efektivitetin e qeverive të mëparshme shqiptare, si Qeveria e Përkohshme e Vlorës, qeveria e Princ Vidit dhe qeveria e dalë nga Kongresi i Durrësit, e cila ishte nën kontrollin e autoriteteve pushtuese italiane dhe me prerogativa dhe ndikim shumë të kufizuar në jetën politike të vendit, por edhe në aspekte të tjera social-ekonomike të saj.

Shtrirja e autoritetit të qeverisë dhe të institucioneve të tjera shtetërore në të gjithë vendin, në prag dhe pas Luftës së Vlorës, ishte një arritje madhore. Gjithashtu fillimi i suksesshëm i procesit të çarmatimit

ishite një arritje tjetër domethënëse e mbresëlënëse. Në këto procese shumë të rëndësishme shtetformuese për kohën, sukcesi i Luftës së Vlorës kishte ndikimin e saj pozitiv të padiskutueshëm.

3. Në prag të fillimit të Luftës së Vlorës, qeveria u përpoq të eliminonte tendencat separatiste që vinin nga forca të ndryshme antiqeveritare. Thelbin e këtij procesi e përbënte eliminimi i Esat Toptanit dhe i forcave që e mbështesnin atë, të cilat po sfidonin hapur ushtarakisht autoritetin e qeverisë, e madje vetë ekzistencën e saj. Kjo ndihmoi në zhvillimin me sukses të Luftës së Vlorës, ndërsa përfundimi i saj e bëri qeverinë dhe institucionet më të fuqishme për t'u përballuar me forcat separatiste ose centrifugale, të cilat u hodhën në veprim veçanërisht gjatë vitit 1921 në zgjedhjet politike dhe pas formimit të parlamentit të parë të zgjedhur rregullisht në verë të këtij viti.

4. Organizimi i Luftës së Vlorës dhe sukcesi i saj, ashtu si dhe më parë organizimi i Kongresit të Lushnjës, më së shumti ishin meritë e një organizate të fshehtë politike e themeluar qysh në vitin 1914, e cila quhej “Krahu Kombëtar”. Organizimi i saj sekret sipas modelit xhonturk, karakteri i saj i spikatur nacionalist dhe sukseset e lartpërmendura e shndërruan atë, në vitin 1920 dhe në vijim, në një forcë politike të fuqishme, e cila nuk kishte konkurrent një fuqi politike të përafërt me të, në skenën politike shqiptare të kësaj kohe. Kjo pati disa rrjedhoja shumë të rëndësishme politike për vendin në vitet 1920-1924.

*Së pari*, krijoi një disbalancë në konstelacionin e forcave politike, ku “Krahu Kombëtar” si organizatë sekrete, e cila në fundin e vitit 1920 e më tej përbënte shtyllën e “Partisë Popullore”, ishte forca kryesore qeverisëse e viteve 1920-1924. Lufta e Vlorës i dha kësaj organizate një prestigj e ndikim politik të konsiderueshëm, duke ia shtuar fuqinë e mëparshme politike që ajo zotëronte.

*Së dyti*, veçanërisht në vitet 1920-1921, “Krahu Kombëtar” kishte një stabilitet politik të brendshëm dhe deri diku një kohezion më të madh se çdo forcë politike në vend. Në vitin 1920 kjo ndikoi në një qeverisje deri diku stabile dhe të suksesshme.

*Së treti*, “Krahu Kombëtar” me organizimin e Kongresit të Lushnjës, e veçanërisht me organizimin e Luftës së Vlorës, u afirmua si një forcë nacionaliste e pakompromis, që sfidoi hapur projektet dhe synimet e politikës italiane kundrejt Shqipërisë. (Vendosjen e Protektoratit mbi shtetin shqiptar dhe aneksimin e Vlorës dhe të hinterlandit të saj). Kështu, kjo forcë qeverisëse u afirmua si forcë

kryesore antiitaliane në Shqipëri. Për këtë arsye, mbi të, qoftë si grup qeverisës, qoftë si forcë politike do të ushtrohej presioni i fuqishëm i këtij shteti, për ta përçarë, eliminuar si forcë politike, ose për të marrë nën kontroll drejtimin e saj.

5. Në këtë kontekst mund të nënvizohet se suksesi i Luftës së Vlorës ndikoi thelbësisht në riorientimin e objektivave të politikës italiane kundrejt Shqipërisë. Tashmë protektorati dhe aneksimi i Vlorës u zëvendësuan nga përpjekjet për sigurimin e monopolit të kontrollit politik dhe ekonomik italian në Shqipëri. Kjo ishte një sfidë madhore për kombin dhe shtetin e ri, i cili do të detyrohej që suksesit historik të Luftës së Vlorës, t'i paguante një haraç të rëndë, duke u përballur me ndërhyrjen dhe presionin shkatërrimtar italian, kryesisht brenda vendit por edhe në arenën ndërkombëtare.

Presioni italian i cili kishte karakter politik dhe agjenturor, do të merrte trajta të qarta qysh pas përfundimit të Luftës së Vlorës dhe do të vijonte më tej edhe pas afirmimit ndërkombëtar të Pavarësisë së Shqipërisë (pranimi të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve më 17 dhjetor 1920 dhe vendimit të Konferencës së Ambasadorëve, 9 nëntor 1921).

Ky presion pati pasoja të shumta e të rënda në politikën e brendshme shqiptare:

- Shtoi përçarjen dhe konfliktualitetin politik në Shqipëri.
- Italianët në radhë të parë zgjodhën të fuqizonin ndikimin në forcën kryesore irredentiste, Komitetin “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (KMKK), duke e mikluar këtë organizatë patriotike me gjoja mbështetjen më të fuqishme që do t'i jepnin për çlirimin e Kosovës nga sundimi serb, nëse ajo ndiqte këshillat italiane. Në këtë mënyrë diplomacia dhe agjentura italiane nxiti mosmarrëveshjet dhe më tej konfliktin midis një pjese të rëndësishme të drejtuesve të KMKK-së dhe të qeverive të kësaj kohe.

- Largimi i elementëve irredentistë, si Hasan Prishina, Hoxha Kadriu etj., nga “Krahu Kombëtar” ishte çarja e parë e dhimbshme e kësaj organizate, e cila ndodhi shumë shpejt pas Luftës së Vlorës. Kjo hemorragji do të vijonte në vitet që pasuan dhe në të shumtën e rasteve presionet politike italiane kishin një vend të rëndësishëm në stimulimin e këtyre krizave shpërbërëse.

6. Lufta e Vlorës e pakësoi edhe më tej influencën politike dhe prestigjin e individëve italo-filë të qeverisë së Durrësit, të cilët pjesërisht kishin pranuar si kompromis një ndikim dhe rol të veçantë të Italisë në

çështjet shqiptare. Midis tyre ishin krerë të rëndësishëm, si Mustafa Kruja, Myfid Libohova, Fejzi Alizoti, kleri katolik i Shkodrës me në krye Luigj Gurakuqin e Luigj Bumçin etj.

Rezultati i arritur pas Luftës së Vlorës bëri që këta elementë të fuqishëm proitalianë të tërhiqeshin gradualisht nga pozicioni i hapur armiqësor kundrejt Kongresit të Lushnjës dhe qeverisë së dalë prej tij, në zgjedhjet politike shqiptare, në institucionet politike, e në radhë të parë në Parlamentin e parë Shqiptar. Sigurisht, kjo ishte një arritje pozitive për normalizimin e vendit dhe stabilizimin e shtetit, por nga ana tjetër, ata do të përbënin një forcë opozitare ndaj “Partisë Popullore” dhe boshtit të saj “Krahut Kombëtar”, e cila në disa raste do t’i kalonte caqet e opozicionit legal dhe do të degjeneronte në grushte shteti (dhjetor 1921) ose në kryengritje të armatosura antiqeveritare (mars 1922).

Nxitja e fshehtë italiane dhe mbështetja me mjete monetare e këtyre veprimeve ishte më se e qartë dhe vihej në pah nga diplomatët e huaj, në radhë të parë nga ata britanikë dhe komisionet e Lidhjes së Kombeve në Shqipëri.

Pra, fitorja e Luftës së Vlorës ishte me rëndësi jetike për ekzistencën e Shqipërisë së pavarur, por nga ana tjetër, ajo u bë shkak që Italia të nxiste përçarjen dhe konfliktualitetin politik në Shqipëri deri në nivele ekstreme dhe shpërbërëse. Klasa e re politike shqiptare, pa përvojë qeverisëse, pa kapacitet të madh politik dhe format të lartë nacionalist, sa të përballonte e të absorbonte këtë presion italian, u bë pre e tij, ç’ka pati pasojë tepër të dhimbshme në destabilizimin e Shqipërisë.

Por, këto pasojë që lidheshin me dështimin e objektivave aneksioniste italiane kundrejt Shqipërisë, nuk e zhvleftësuan fitoren e arritur në Luftën e Vlorës, ndonëse në disa raste e vunë në pikëpyetje atë.

*Si përfundim*, mund të themi se, klasa drejtuese shqiptare e asaj kohe u tregua largpamëse dhe në lartësinë e duhur kur organizoi me sukses Kongresin e Lushnjës dhe Luftën e Vlorës, duke siguruar mbijetesën e shtetit të pavarur shqiptar. Por nga ana tjetër, pas Luftës së Vlorës, ajo nuk ishte në gjendje të ruante kohezionin e duhur përballë presioneve të huaja dhe u tregua e paaftë për të krijuar një vizion të qartë për ndërtimin e një shteti të pavarur kombëtar dhe për gjetjen e kompromisit dhe të konsensusit të domosdoshëm e jetik për ekzistencën dhe konsolidimin e këtij shteti. Për pasojë, në vitet 1921-1924, Shqipëria

kaloi një situatë dramatike që u shoqërua me kriza të rënda politike, të cilat vunë në pikëpyetje ekzistencën dhe pavarësinë e saj.